

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-265/13

**Prishtinë
24 Shtator 2014**

Në çështjen juridike të:

D. P.

Kotor

Paraqitësi i kërkesës / Pala ankuese

Kundër

Nuk dihet

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Esma Erterzi, Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/209/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA28552), të datës 11 qershor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 24 Shtator 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. P. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/209/2013, e datës 11 qershor 2013.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/209/2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA28552, i datës 11 qershor 2013.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 06 mars 2007, D. P., si anëtar i ngushtë i familjes së bartësit të së drejtës pronësore – vajzës së tij L. P., ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore dhe ri-posedimin e pronës- lokalit afarist. Ai pretendon se vajzës së tij i është lejuar ta ndërtojë një objekt afarist në ngastrën nr.1093/1, rruga “Vukmirovića”, Zona Kadastrale dhe Komuna e Pejës. Objekti afarist sipas z. Perović ka sipërfaqe prej 60 m².
2. Ai ka deklaruar se humbja e posedimit të objektit afarist ka ndodhur për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërsëdrejti me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999, duke përmendur 12 qershorin 1999 si datë të humbjes së saj.
3. Për ta mbështetur kërkesën, ai ka paraqitur, *inter alia*, lejen e vozitjes, të lëshuar më 07 shtator 2006 nga Komuna e Kragujevcit, Republika e Serbisë; certifikatën e lindjes të vajzës së tij, 200-9567/2000-VI të lëshuar më 28 nëntor 2000, një kopje të vendimit nr. 03-353/347, të lëshuar më 5 qershor 1992 nga Këshilli Ekzekutiv, Kuvendi Komunal në Pejë. Kjo kopje e vendimit vërteton se L. P. i është dhënë lokacioni për të ndërtuar një objekt të përkohshëm-montazh prej 32m² (e jo 60 m² siç pretendohet) në një pjesë të ngastrës kadastrale nr. 1093, gjithashtu edhe vendimi nr. 03-351/2376, i lëshuar më 19 nëntor 1992 nga Enti për Urbanizëm, çështje Banësore, Pronësore-Juridike, i cili i jep asaj të drejtën e ndërtimit të një objekti të përkohshëm-montazh në një pjesë të ngastrës nr. 1093/1. Me vendim e theksuar konstatohet se nëse lokacioni nevojitet për realizimin e planit urbanistik, përfituesit i kësaj leje do ta largojë objektin pa të drejtë kompensimi dhe se nuk do ti ofrohet një ngastër tjetër.

4. Më 26 mars 2007, zyrtarët e AKP-së kanë bërë identifikimin e pronës së kërkuar me vendosjen e formave përkatëse dhe kanë gjetur se objekti afarist është larguar nga Komuna e Pejës dhe se ngastra nr. 1093/1 është duke u shfrytëzuar si park. Komuna e Pejës e përfaqësuar nga A. S. (drejtor për çështje pronësore-juridike) nuk e kishte nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje, por ka paraqitur përgjigje në kërkesë duke pretenduar se z. P. nuk ka ofruar prova që dëshmojnë të drejtën pronësore ndaj pronës. Komuna e Pejës ka paraqitur fletën poseduese nr. 2608 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, ku thuhet se prona e kërkuar është pronë shoqërore dhe se Kuvendit Komunal i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të saj. Përderisa asnjëherë nuk është paraqitur asnjë njoftimi për pjesëmarrje, kërkesa mbetet e pakontestueshme.
5. Vendimi nr. 03-351/2376 i lëshuar më 19 nëntor 1992 është verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-së, ndërsa fleta poseduese nr. 2608 është verifikuar, *ex officio*, dhe ngastra nr. 1093/1, është gjet të jetë pronë shoqërore. Certifikata e lindjes që dëshmon lidhjen familjare të paraqitësit të kërkesës me vajzën e tij, si dhe kapacitetin e paraqitësit të kërkesës për të paraqitur kërkesë, nuk është verifikuar nga ekipi verifikues i AKP-së. Gjykata Supreme nuk e pa të nevojshme verifikim e certifikatës së lindjes, duke pasur parasysh se nuk do të kishte ndikim në rezultatit përfundimtar të kërkesës.
6. Më 11 qershor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), me vendimit të vet KPPC/D/C/209/2013, e ka refuzuar kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. Në arsyetimin e vendimit të vet, KKPK-ja ka vendosur se në bazë të provave, paraqitësit të kërkesës i është dhënë e drejta e shfrytëzuesit të përkohshëm të pronës së kërkuar, prandaj ai ishte i autorizuar vetëm për ndërtimin e një objekti të luajtshëm në pronën e kërkuar. Prona e kërkuar duhet të konsiderohet si objekt i luajtshëm sipas nenit 9 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154). Në anën tjetër, në pajtim me paragrafin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KKPK-ja nuk ka juridiksion që të vendos për objektet e luajtshme.
7. Vendimi i është dorëzuar D. P. më 13 gusht 2013, dhe ai ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme më 03 shtator 2013 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese); Komuna e Pejës nuk është njoftuar rreth vendimit pasi nuk ishte palë në procedurë para AKP-së, prandaj ankesa ndaj Vendimit nuk u është dorëzuar.

Pretendimet e paraqitësit të kërkesës/palës ankuese

8. Pala ankuese ka pretenduar se vendimi i KKPK-së mbështetet në shkelje thelbësore dhe zbatimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale, sepse versioni i vendimit në gjuhën serbe,

saktësisht dispozitivi nuk përmban numrin e kërkesës së paraqitur KPA28552, gjithashtu versioni i vendimit në gjuhën angleze nuk përmban dispozitiv lidhur me kërkesën e paraqitur KPA28552. Pala ankuese në vazhdim ka pretenduar se vendimi i KKPK-së është i bazuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak se prona-objekti afarist nuk është pronë e luajtshme private, si është vendosur për të nga organi vendimmarrës, por se kjo pronë është pronë e paluajtshme private. Pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme ta ndryshojë vendimin e AKP-së, KPCC/D/C/209/2013 të datës 11 qershor 2013 dhe t'ia vërtetojë të drejtën pronësore palës ankuese.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

9. Ankesa është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me Ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Gjykata Supreme ka juridiksion ndaj ankesave kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

10. Në vijim të rishikimit të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në përputhje me nenin 194 të LPK-së, Gjykata Supreme gjeti se ankesa është e pabazuar.
11. KKPK-ja ka bërë vlerësimin e saktë të provave kur ka vendosur se kërkesa është jashtë fushëveprimit të vet. KKPK-ja ka dhënë shpjegime të plota, gjithëpërfshirëse, të sakta, dhe të ligjshme, si dhe sqarime për faktet kryesore për një vendim të drejtë.
12. Lidhur me pretendimin e palës ankuese së vendimi i KKPK-së është i paqartë, KKPK-ja ka marrë një vendim të vërtetuar më 11 qershor 2013, vendimi i është referuar “paragrafëve përkatës” të Vendimit Grupor. Një referim i veçantë i është bërë paragrafëve 9 dhe 21. Prandaj, Gjykata Supreme do të bëjë një përmbledhje të shkurtër të arsyeve se pse KKPK-ja nuk ka juridiksion për këtë lëndë.
13. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë nga Komisioni në urdhër për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon të drejtën ndaj pronës, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojnë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo

që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Në vështrim të kësaj dispozite, pason se juridiksioni i Komisionit për Kërkesa Pronësore i AKP-së dhe kështu i Gjykatës Supreme është i kufizuar ekskluzivisht në zgjidhjen dhe vendosjen e kërkesave pronësore për prona të paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale.

14. Gjykata Supreme vëren se sipas vendimit nr. 03-353/347, të lëshuar më 5 maj 1992 nga Kuvendi Komunal i Pejës dhe vendimit nr. 05-351/2376, të lëshuar më 19 nëntor 1992 nga Enti për urbanizëm, çështje komunale-banesore dhe inxhinierisë civile të Komunës së Pejës, vërtetohet se L.P. i është dhënë toka për shfrytëzim të përkohshëm për ngritjen e një objekti afarist në një pjesë të ngastrës nr. 1093/1, në rrugën “Vukmirovića”, zona kadastrale dhe komuna e Pejës. Leja është dhënë për vendosjen e përkohshme të objektit në atë ngastër, i cili konsiderohet si objekt i luajtshëm.
15. Gjykata Supreme po ashtu konsideron se prona e kërkuar në pajtim me dispozitën e nenit 9, paragrafi 1 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154) është objekt i luajtshëm. Në pajtim me këtë dispozitë ligjore, rrjedh se objektet e përkohshme- montazh, kioskat dhe struktura të përkohshme-montazh, sikurse në rastin konkret, nuk konsiderohen si objekte të paluajtshme. Për më tepër, neni 14 paragrafi 1 dhe neni 26 paragrafi 2 i Ligjit për Ndërtimin (Gazeta Zyrtare e SAPK nr. 14/80) përcakton se kur një organ kompetent bënë një ndarje për shfrytëzim të përkohshëm për nevoja të përkohshme të aplikuesit për vendosjen e strukturave të përkohshme-montazh, atëherë ai organ ka të drejtë, në përputhje me nevojat e planifikimit urban, ta zhvendos atë strukturë me shpenzime personale të shfrytëzuesit. Një objekt i përkohshëm nuk mund të jetë temë për njohjen e të drejtës pronësore dhe as të regjistrohet në regjistra të pronës të zyrës kadastrale.
16. Z. P. ka bërë pretendimet e tij se prona-objekti afarist ishte një pronë e paluajtshme private. Gjykata Supreme nuk e sheh të nevojshme ta shtjellojë nëse objekti afarist i cili ishte ndërtuar në ngastër ishte një objekt i përkohshëm apo i përhershëm, në kuptim fizik. Shihet qartë nga provat e paraqitura se P. i është dhënë vetëm leja e ndërtimit të një objekti të përkohshëm.
17. Në anën tjetër, pala ankuese ka kërkuar të drejtën pronësore, të drejtën e posedimit të ndërtesës së ndërtuar në pronën shoqërore. Pasi që kërkesa është e lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të pronës shoqërore dhe jo të pronës private, Gjykata Supreme gjen se kërkesa nuk është në juridiksion të KKKP-së. Ligji e përcakton qartë se vetëm e drejta e pronësisë, posedimi ligjor, apo e drejtë e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, mund të jenë temë procedure para AKP-së. Sipas jurisprudencës së Kolegjit për Ankesa të AKP-së, objekti e përkohshëm nuk mund të konsiderohet si pronë e paluajtshme duke e lënë çështjen jashtë juridiksionit të AKP-së.

18. Prandaj, vendimi ankimor nuk përbën ndonjë shkelje thelbësore dhe as zbatim të gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale. Po ashtu ky vendim nuk është i bazuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, siç është pretenduar nga pala ankuese.
19. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ankesa është refuzuar si a pabazuar si dhe është konfirmuar vendimi i KKPK-së për sa i përket lëndës për të cilën është vendosur me këtë aktgjykim (KPA28552).
20. Ky aktgjykim nuk përmban paragjytime mbi të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të kërkuar të drejtat e veta para gjykatave kompetente.

Këshillë juridike

21. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it